



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverballi i mbajtur më 26 shtator 2016, në mbledhjen e XXXII-të (tridhjetedy) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç znj.Endritë Murati, dhe z.Xhevdet Beselica të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Agim Veliu Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht përshëndeti të pranishmit, theksoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje u është dërguar me kohë. Gjithashtu konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa u janë shpërndarë në hyrje të kësaj mbledhjeje, andaj konsideroj se mund të vazhdojmë me punë dhe vendimmarrje, e hapë debatin.

z.Avni Ajeti, theksoi, sot e bëjë një prononcim, faktikisht tërhiqem nga aktiviteti politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës, këtë e bëj për arsye personale dhe shkaqe familjare, kështu që falënderoj të gjithë për bashkëpunimin. Gjithashtu falënderoj edhe Kryetarin e Komunës që njëherit është edhe Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës – Dega në Podujevë, gjithë elektoratin e Lidhjes Demokratike të Kosovës si dhe gjithë votuesit të cilët më kanë votuar mua për këshilltar të Kuvendit të Komunës. Po ashtu kam një kërkesë për kryesuesin e Kuvendit, që mundësisht sot të lirohem nga kjo seancë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe ne falënderojmë z.Avni Ajetin për angazhimin e deritanishëm në Grupin e këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe po ashtu i dëshirojmë punë të mbarë në të ardhmen.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, meqë pak më parë këshilltari i Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës – Dega në Podujevë, z.Avni Ajeti deklaroi për pushimin e aktivitetit politik të tij në Lidhjen Demokratike të Kosovës, unë e përkrah vullnetin e lirë të tij, vullnet sipas të cilit edhe është bashkuar në radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës para disa viteve dhe që kemi rrugëtuar bashkërisht deri tani. I përmenduri theksoi se pushimin e aktivitetit e bën për arsyt e tij personale dhe familjare, unë e kuptoj atë dhe për këtë nuk kam kurrfarë arsye të dyshoj. Meqë deklarata u bë sot këtu publikisht, unë falënderoj këshilltarin e Kuvendit z.Avni Ajetin për punën dhe kontributin e dhënë për vitet e kaluara në LDK, i cili gjithëherë ka qenë i përkushtuar dhe përkrahës i qëndrimeve dhe formësimit të vendimeve të LDK-së, si dhe konsekuent dhe akter i atyre vendimeve, për çka i dëshiroj të gjitha të mirat këtij dhe familjes së tij, duke i dëshiruar që

sa më shpejt të pushojnë ato shkaqe personale dhe familjare në mënyrë që aktivitetin e tij politik ta vazhdoj atje ku e ndjenë veten më së miri.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më 23 shtator 2016 ne i kemi rekomanduar Kuvendit rendin e ditës ashtu siç ka qenë, për të diskutuar në Kuvend, mirëpo nga ajo ditë ka rrjedh edhe një kërkesë e cila i është paraqitë Grupit të këshilltarëve të PDK-së, mirëpo për Grupet tjera dhe për Kryesuesin e Kuvendit nuk jam në dijeni se a ka arritur. Kërkesa është nga punëkryesi i Obeliskut "Afrim Zhitia", Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë sa i përket kësaj çështjeje më ka njoftuar se më datën 20.03.2013 dhe më 25.03.2016 nga Sekretari Permanent janë dërguar dy kërkesa zyrtare drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z.Abaz Llugaliu, lidhur me hapësirën e Obeliskut "Afrim Zhitia", për arsye se mjetet financiare të parapara nga niveli qendrorë për ndërtimin e Obeliskut mund të përdoren vetëm brenda këtij viti, ndërsa tani jemi në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Projekti është i gatshëm, mirëpo çështja e uzurpimit të pronës përkatëse e ka mbajtur peng realizimin e projektit në fjalë. Konsideroj se buxheti për këtë projekt e ndihmon Komunën e Podujevës sepse Komuna nuk participon me mjete buxhetore, andaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së kërkojmë që kjo çështje të futet sot si pikë e rendit të ditës në mënyrë që të kemi mundësi të diskutojmë për Obeliskun "Afrim Zhitia" dhe njëkohësisht të marrim përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë si dhe drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit, ngase sa jam në dijeni, për pronën në fjalë janë mbajtur edhe disa seanca gjyqësore mes Komunës dhe uzurpatorit. Pra edhe njëherë kërkojmë që sot të debatohet për këtë çështje dhe ne si Kuvend të nxjerrim një konkluzion apo një përgjigje për Ministrinë e cekur, për investitorin dhe për punëkryesin. Ne kemi propozimin, por mbetet në ndërgjegjen e Kuvendit të Komunës dhe të këshilltarëve të Kuvendit që të votojnë për ose kundër ndërtimit të Obeliskut "Afrim Zhitia", si dhe të votojnë për ose kundër ardhjes së investimeve nga niveli qendrorë në Komunën e Podujevës. Ne si Grup nga radhët e PDK-së kërkojmë të diskutohet dhe të jepet një po "Afrim Zhitisë", për Obeliskun e cekur, ndërsa për Grupet tjera mbetet të vendosin si të dëshirojnë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë si Kryesues i Kuvendit nuk kam asnjë informatë lidhur me ndonjë dokument me shkrim nga Ministria në fjalë për çështjen që parafolësi e cekur, mirëpo edhe nëse një kërkesë e tillë dërgohet ajo shkon përmes Ekzekutivit të Komunës – Drejtorive përkatëse, që për çështje të tilla i propozojnë Kuvendit duke dërguar lëndën e kompletuar. Unë jam i obliguar që propozimin e parafolësit ta hedh në votim, mirëpo konsideroj se nuk mund të debatojmë pa pasur materialin konkret, kështu që unë personalisht jam që mos të futet në këtë mbledhje si pikë shtesë e rendit të ditës propozimi në fjalë.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së nuk jemi kundër çështjes së ngritur nga këshilltari parafolës, mirëpo vetëm të kemi materialin përkatës dhe të diskutojmë për këtë çështje në një seancë tjetër të radhës. Po ashtu asnjëherë nuk jemi dhe nuk kemi qenë kundër ndonjë investimi të nivelit qendrorë, përkundrazi gjithherë i kemi përkrahur ato. Po ashtu jemi dëshmitarë që falë dëshirës, angazhimit dhe përkushtimit të madh të Kryetarit të Komunës janë duke ardhur investime milionëshe në Komunën e Podujevës në këtë mandat të Qeverisë së Republikës së Kosovës, prandaj e përsërisë se asnjëherë ne nuk kemi qenë kundër, por përkundrazi gjithherë i kemi përkrahur dhe vazhdojmë t'i përkrahim investimet e nivelit qendrorë që bëhen në Komunën e Podujevës, mirëpo për çështjen në fjalë, nuk kemi material, andaj mendojmë që është mirë që për këtë çështje të diskutohet në një seancë tjetër kur të na dërgohet edhe materiali përkatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk dëshiroj të ngriti debat, mirëpo për çështjen e Obeliskut "Afrim Zhitia" mendoj që nuk është pikë që nuk jemi të njoftuar të gjithë. Nuk është problemi se a jemi

për apo kundër investimeve, mirëpo edhe parafolësi si shef i Grupit të LDK-së por edhe unë si shef i Grupit të PDK-së jemi të njoftuar që ajo pronë është e uzurpuar dhe për këtë çështje parafolësi është dashur të mbaj takim me Grupin e tij për këtë çështje. Pastaj është drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit, për të cilën unë në këtë foltore e kam thënë se asnjëherë nuk do të diskutoj rreth asaj Drejtorie deri sa drejtoresha ta shfleton problemin e pronave në Komunën e Podujevës, andaj në qoftë se ajo nuk është marrë asnjëherë me çështjen e ngritur ne patjetër duhet ta ngrisim në Kuvend. Kërkesa në fjalë i është dërguar z.Abaz Llugaliut, drejtor i Drejtorisë së Pronës kadastrit dhe Gjeodezisë, por nëse ai nuk e posedon, unë ja jap një kopje fizike. Pra unë nuk kamë asgjë për të debatuar individualisht me askënd, mirëpo ishte propozim i imi dhe kërkoj të hedhet në votim, kalon apo nuk kalon është çështje demokratike.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, së pari jam i mendimit se nuk është mirë që të votohet për çështjen e ngritur nga parafolësi, sepse z.Rafet Llapashtica e tha të votohet dhe t'i jepet një, po, "Afrim Zhitisë", e unë konsideroj se nuk jemi ne ata të cilët mund t'i japim as, po, e as, jo, "Afrim Zhitisë" dhe asnjërit prej luftëtarëve dhe Heronjve që e kanë dhënë jetën për këtë vend. Ne i respektojmë shumë ata, por nuk është mirë që të vihet ky Kuvend në atë pozicion që të thuhet mandej që dikush i tha po e dikush jo kësaj çështjeje, pra këtë ta kemi të qartë, ne kemi vlerësim për të gjithë dhe çka do që është në mundësitë tona duhet të bëjmë për ta, madje konsideroj se është pak ajo që ne e bëjmë në krahasim me veprat e tyre, mirëpo dikush ka qenë dhe është gjithmonë i disponuar që këto çështje t'i përdorë më shumë, dikush i përdorë më pak dhe ka edhe të tillë që nuk i përdorin fare. Nuk është mirë që me gjëra të tilla të bëhen lojëra dhe të vihen në sprova të tilla këshilltarët. Çështja e dytë është se për këtë çështje, në zyrën time, kam mbajtur takim edhe me Ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë z.Ferid Agani të cilit i kam dhënë të gjitha sqarimet lidhur me këtë problematikë ashtu sikur se që i kam dhënë edhe më parë para këtij Kuvendi, se nuk është mirë të ndërmarrim veprime të ngutshme pa i vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, ngase mund të mendojmë se jemi duke vepruar të mirë, por pas atyre veprimeve mund të rrjedhin pasoja. Unë edhe sot jam i mendimit të mëhershëm se nuk është mirë të ngutemi për këtë çështje.

Arsyeja e tretë se kjo çështje nuk duhet të diskutohet në këtë mbledhje të Kuvendit, është fakti se për këtë problem ka filluar një proces gjyqësorë, ne e kemi paraqitë lëndën, lënda është në Gjykatë, andaj për lëndë të cilat janë në procedurë gjyqësore nuk është mirë të diskutohet sepse mund të bëjmë prejjudikime të ndryshme, ose për të mirë ose për të keq, kurse Gjykata është e pavarur dhe ajo sigurisht vendos në bazë të fakteve. Ne si Komunë kemi konstatuar gjendjen se si është në atë lokacion, lënda është e kompletuar dhe presim përfundimin e atij epilogu, dhe pastaj kur të kemi një vendim nga Gjykata atëherë neve si organe komunale, qoftë Ekzekutivit qoftë Kuvendit i krijohet mundësitë për marrim vendime përkatëse. Nëse në ndërkohë do të ketë ndonjë lëvizje lidhur me këtë çështje, do të konsultohem me drejtorë të Drejtorive për veprimet e mëtejshme.

Nëse e vlerësojmë të nevojshme, unë që sot i ftoj në një takim shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, Kryesuesin e Kuvendit dhe drejtorin e Drejtorisë përkatëse, në mënyrë që të analizojmë dhe vlerësojmë gjendjen, e pastaj varësisht nevojës ne mund ta thërrasim edhe një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës ku mund të diskutohet dhe mund të merret një vendim apo qëndrim lidhur me këtë çështje.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se propozimi i Kryetarit të Komunës ishte konkret dhe propozim me vend. Besoj se shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe unë si Kryesues i Kuvendit jemi të gatshëm të takohemi ashtu siç propozoj Kryetari i Komunës, kështu që jam i mendimit të mos debatojmë në këtë seancë duke pasë parasysh se kemi mjaft tema të

rëndësishme për këtë mbledhje, ndërsa në një prej mbledhjeve të radhës mund të diskutojmë rreth çështjes në fjalë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Kryetari i Komunës e tha se kjo çështje po përdoret, unë absolut nuk kam asgjë personale dhe nuk jam në disponim aspak të diskutoj për një histori për të cilën jemi në dijeni të gjithë dhe nuk kam asgjë personale rreth kësaj çështjeje. Unë mendoj se Kryetari i Komunës e dinë se ajo pronë është e uzurpuar, kurse kërkesën e posedon drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z.Abaz Llugaliu, ndërsa Kryetari i Komunës nuk e posedon atë. Unë edhe në mbledhjen e KPF-së e kam thënë se nuk jam i disponuar që të gjitha detyrat e përcaktuara me kontratë të adresohen te Kryetari i Komunës duke përfshirë edhe çështjen e arsimit, dhe në këtë aspekt mendoj se të gjithë në pozitë – opozitë duhet të kemi disponim për një qeverisje të mirë, por mendoj se Kryetari i Komunës është dashur të thërret drejtoreshën e Drejtorisë së Inspeksionit, e them këtë ngase unë si shef i Grupit të të këshilltarëve të PDK-së e kam një vendim të drejtorit z.Abaz Llugaliu i cili e ka lëshuar për Drejtorinë e Inspeksionit, që të lirohet ajo hapësirë, pra e posedoj dokumentin e nënshkruar nga drejtori i lartcekur, që prona është publike dhe që kërkohet nga Drejtoria e Inspeksionit ta liron hapësirën e uzurpuar, andaj pyes drejtoreshën e Drejtorisë së Inspeksionit, a është ndërmarrë ndonjë veprim sa i përket kësaj çështjeje, përkatësisht për lirimin e pronës së uzurpuar sepse lënda është që tri vite.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhjeje dhe rekomandimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se me 26 vota për, 7 vota kundër, dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 23 shtator 2016

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 29 korrik 2016

Pas votimit, njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 29 korrik 2016

3. Propozim i Vendimit për buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018 - 2019

➤ Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë propozim vendim duke përfshirë edhe propozim rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017 si pjesë përbërëse e buxhetit të Komunës, dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Andaj fjalën hyrëse për këtë propozim ja jap drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF) e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera, theksoi bazueshmërin ligjore të propozim buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018-2019, duke dhënë edhe sqarimet për propozim Rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017 si pjesë përbërëse e buxhetit të Komunës, se në krahasim me Rregulloren në fjalë për vitin 2016, i vetmi ndryshim është se

norma tatimore për garazha është zvogëluar nga 0.20%, në 0.15%, dhe i njoftoj këshilltarët se kjo propozim Rregullore është dërguar paraprakisht në Ministrinë e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, ku edhe është marrë përgjigje pozitive, andaj si e tillë mund miratohet.

Buxheti i propozuar për Komunën e Podujevës për vitin 2017 është 19,284,786.00 €, dhe përbëhet prej dy burimeve; 1-grandi Qeveritar në shumë 17,436,986.00 €, ku përfshihen, Administrata Komunale 6,311,725.00 €, shëndetësi primare 2,933,443.00 €, dhe arsim parafillorë, fillor dhe të mesëm 8,133,946.00 €, si dhe 2-të hyrat vetanake të planifikuara në shumë 1,847,800.00 €, ku përfshihen, të hyrat vetanake Komunale 1,677,800.00 €, të hyrat nga shëndetësia 72,000.00 € dhe të hyrat nga arsimi 98,000.00 €. Propozim buxheti është shpërndarë sipas instruksionit të Ministrisë së Financave në kategori dhe programe të caktuara ekonomike, dhe mund të ndahet në dy pjesë; -Shpenzime operative në shumë 13,812,307.00 € nga të cilat vlen të ceket se edhe përkundër buxhetit të vogël që kemi për subvencione kemi ndarë 40,000.00 € për bursa për nxënës dhe studentë, 50,000.00 € për shëndetësi dhe mirëqenien sociale, 60,000.00 për kulturë rini dhe sport, dhe 303,988.00 € për bujqësi, mirëpo për këto shuma të ndara jemi të vetëdijshëm se nuk i plotësojnë nevojat dhe kërkesat e shumta në këto fusha, mirëpo kemi vepruar në bazë të mundësive tona buxhetore, si dhe -Shpenzime kapitale në shumë 5,472,479.00 €.

Shqetësim i vetëm i imi sa i përket këtij projekt buxheti është planifikimi i të hyrave vetanake, ku Ministria e Financave si kufij të të hyrave e ka caktuar shumën 1,847,800.00 €, e që mendoj se është një planifikim i mbi vlerësuar dhe vështirë i arritshëm, mirëpo angazhimet tona nuk do të mungojnë në funksion të realizimit sa më të madh të mundshëm.

Gjithashtu vlen të theksohet se propozim projektet janë përfshirë duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë territoriale në Komunën e Podujevës duke u munduar që t'i plotësojmë sa më shumë nevojat dhe kërkesat e shumta të qytetarëve. Projekt buxheti është punuar sipas programeve të Komisionit Evropian BDMS ku janë futur shpenzimet operative dhe planifikimi i të hyrave, dhe sistemi PIP janë futur projektet kapitale në detaje duke përshtetur të gjitha të dhënat e nevojshme të projekteve.

Krejt në fund kërkoj ndjesë për një gabim teknik, përkatësisht në listën e projekteve kapitale të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, sepse projektet me numër 5 dhe 6 janë shkrirë në një projekt i cili nuk figuron në listën – materialin e dërguar, dhe atë, studim i fizibilitetit për pronat komunale që mund të shfrytëzohen dhe të jepen në shfrytëzim për nevoja ekonomike, projekt ky i ri i cili ka shumën prej 10,000.00 €, ndërsa projektet 5 dhe 6 kanë shumën 30,000.00 €, kurse shuma tjetër e mbetur prej 20,000.00 € shpërndahen në projektet tjera, dhe atë, projektit me numër 1 nga shuma prej 84,000.00 € sa është paraparë, rritet në 100,000.00 €, si dhe projekti me numër 3 nga shuma 10,000.00 € rritet në 14,000.00 €. Shpresoj se nëse miratohet ne do ta inkorporojmë në listën finale që do të përcjellët në Ministrinë e Financave për miratim.

z.Fidan Rekalii, theksoi, në Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim propozim vendimin për buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018 – 2019. Konsiderojmë se ky buxhet i paraparë do t'iu ndihmon qytetarëve të Komunës së Podujevës në lehtësimin e jetës së tyre, dhe ajo që vlen të theksohet është se në këtë dokument shohim shumë projekte të rëndësishme dhe projekte të llojeve të ndryshme për lokalitete të ndryshme. Andaj për këto dhe arsye tjera të rëndësishme në Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim duke përfshirë edhe propozim rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket propozim rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017 nuk kemi ndonjë vërejtje, ndërsa te projektet prioritare për vitin 2017 do të propozoj

që te pika 1 për planin e përshkrimit të projekteve ku janë të parapara 100,000.00 € për vendosjen e Shtatores së Heroit "Ali Ajeti", si dhe punimi dhe vendosja e monumentit të tre Heronjëve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushevc, mendoj se duke ditur koston e Shtatoreve dhe atë të punës është mirë që ky buxhet të rritet nëse është menduar të kryhet kjo punë, ndërsa nëse është menduar që vetëm të fillohet me këtë punë, 100,000.00 € janë shumë e vogël e mjeteve për realizimin e këtij projekti në vitin 2017. Ne jemi në dijeni se ka qenë premtim i kahmotshëm dhe që nuk është realizuar asnjëherë dhe në bazë të kësaj shume të ndarë mendojmë se nuk do të realizohet as në vitin 2017, por vetëm mund të jetë ndonjë propozim elektorale i subjektit politikë që është në pushtet për arsye se parashihet ndërtimi i tri Shtatoreve të tre Heronjëve, si dhe Shtatorja e "Ali Ajetit" e cila më duket se është e ndërtuar por gjendet në ndonjë podrum të Komunës, kurse tani sheshi duhet rikonstruktohet me punë tjera në mënyrë që të vendoset Shtatorja e "Ali Ajetit", kështu që ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së propozojmë që kostoja për këtë projekt të rritet për arsye se realizimi i projektit nuk mund të bëhet me koston e paraparë. Çështja tjetër është, shenjzimi vertikal dhe horizontal, ne jemi në dijeni se komisioni përkatës dhe Kuvendi i Komunës e ka kryer punën e vet, është bërë emërtimi i rrugëve dhe është miratuar edhe lista e emrave rezervë, ndërsa tani janë të parapara 35,000.00 €, kurse drejtori i Drejtorisë përkatëse në disa seanca më parë ka deklaruar se është mungesë e mjeteve buxhetore, andaj në qoftë se mendojmë të kryejmë shenjzimin e rrugëve, shuma e paraparë prej 35,000.00 € nuk do të mjafton, mirëpo nëse kemi të bëjmë me shenjzimin e trafikut sigurisht se është diçka tjetër, por unë nuk kam parë ndokund në këtë dokument që brenda tri viteve të ardhshme do të kemi shenjzim të rrugëve me emra të ri të rrugëve, çështje për të cilën mendoj se është emergjente kjo për qytetarët dhe për orientime të ndryshme përmes adresave për arsye se mandati po kalon dhe Vendimi i Kuvendit mund të mos realizohet fare deri në vitin 2020. Pra duhet të parashihen mjete buxhetore që brenda këtyre dy-tri viteve të bëhet shenjzimi i rrugëve me emra të rrugëve, ose të paktën në zonat urbane fillimisht e pastaj në zonat tjera rurale.

Vërejtje tjetër kemi edhe te Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ku në zhvillimin e Komunës e ka paraparë ndërtimin e shtigjeve për biçikleta në fshatin Kërpimeh, vërejtje të cilën e kam dhënë edhe kur kemi debatuar për Kornizën Afatmesme Buxhetore, andaj nuk di si zhvillohet Komuna ekonomikisht me 30,000.00 € duke ndërtuar një shteg për biçikleta në fshatin Kërpimeh, por mendoj se kjo shumë e mjeteve më shumë do të vlente për shenjzimin e adresave se sa të përcjellët projekti deri në vitin 2019 për ndërtimin e shtigjeve për biçikleta në fshatin Kërpimeh. Pra kjo ishte vërejtje por edhe si pyetje për drejtorin përkatës, se si do të zhvillohet Komuna me ato 30,000.00 € për ndërtimin e shtigjeve për biçikleta. Gjithashtu edhe te Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit vazhdimisht deri në vitin 2019 kemi projektin, ndërtimi i fushave të hapura sportive në fshatin Kërpimeh, projekt ky i propozuar edhe mandatin e kaluar sa jam në dijeni, por që nuk është realizuar asnjëherë, dhe për të cilin drejtori përkatës ka premtuar që në këtë vit do të përfundoj ai projekt por sipas këtij dokumenti ai projekt parashihet deri në vitin 2019, kështu që kam vërejtje në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit sepse tani kemi edhe vendimin për KF "Llapi" i anuluar nga Ministria përkatëse dhe gjëra tjera. Andaj ne si Grup i këshilltarëve i kemi këto propozime të cilat janë në të mirë të drejtorëve ekzekutiv për t'i kryer punët e tyre mirëpo mbetet çështje e Grupeve tjera të Kuvendit se a i mbështesin apo jo.

z.Haki Rudari, theksoi, për Grupin e këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje – qendra në Podujevë, buxheti vjetor i Komunës paraqet një dokument të rëndësishëm për Komunën ku mënyra e planifikimit, menaxhimit dhe shpenzimit si dhe ndarjes së tij ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve të Komunës dhe zhvillimit të tërësishëm. Ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të veçantë këtë projekt buxhet dhe kemi konstatuar se projektimet buxhetore

nuk shprehin kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Podujevës dhe nuk shfrytëzohet potenciali lokal për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Buxheti komunal është hartuar dhe planifikuar në mënyrë jo të mirë, me pjesëmarrje shumë të vogël të qytetarëve dhe do të thoja shumë pak transparent. Sa unë kam përcjellë, janë mbajtur dy takime me qytetarë në muajin qershor dhe më nuk ka pasur takime me qytetarë sidomos gjatë muajit shtator për t'i marrë kërkesat e qytetarëve. Po ashtu planifikimi dhe ndarja buxhetore nuk i mbulon nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe zonave të caktuara, prandaj ky dokument në aspektin teknik nuk ofron sqarime të nevojshme për përfundimin e projekteve të ndryshme dhe në shumë raste thuhet vazhdim i projekteve apo vetëm jepet kodi, vlera ose shuma dhe asgjë më shumë. Gjithashtu ky projekt buxhet përqendrohet në asfalt dhe kanalizim, që në parim është mirë, por megjithatë mbesin anash shumë sektorë tjerë të rëndësishëm të Komunës tonë, siç janë; kujdesi social, shëndetësia, kultura, sporti, bujqësia, arsimi, mjedisi jetësorë dhe shumë të tjera, madje në bujqësi kemi zvogëlim të buxhetit për subvencione në krahasim me vitet paraprake. Nga këto që u thanë mund të vijmë në përfundim se Komuna e Podujevës dhe qytetarët e saj meritojnë një buxhet ndryshe nga ai i paraqitur nga qeverisja aktuale, një buxhet ku në fokus është qytetari, ku merren kërkesat e qytetarëve në mënyrë që buxheti të jetë sa më afër tyre.

Jeni në dijeni se është viti i tretë që Lëvizja Vetëvendosje jep propozimet e veta për inkorporim në buxhetin e Komunës, por megjithatë nuk merren parasysh, prandaj propozimet tona të mëhershme duke filluar nga, kontrollimi mjekësorë për nxënës në mënyrë të rregullt, pastaj pajisje e shkollave me mjete dhe infrastrukturë të ndryshme, shujta për nxënësit që çdo herë e më shumë po bëhet kërkesë nga ana e nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve por që ka mbet në vesh të shurdhër nga qeveria aktuale. Unë mendoj se nuk është mirë të injorohen ashtu gjitha kërkesat e opozitës aq më pak kur kërkesat janë në interes të qytetarëve pa dallime të ndryshme. Në rast se hymë në detaje të projekteve të Drejtorive të ndryshme, duke filluar nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka shumë raste ku nuk ka specifikime fare por ajo çka neve na ka bërë përshtypje është në faqet 7, 8 dhe 9, ku në faqen 9 nga të hyrat vetanake kemi vetëm 10,000.00 € për ndërtimin dhe vendosjen e Shtatores "Ali Aleti" në qytet, mendoj se është shumë e vogël e mjeteve për këtë projekt, të njëjtin rast e kemi edhe te ndërtimi në Qytet i bulevardit dhe sheshit të Dëshmorëve "Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushevci" ku nga të hyrat vetanake kemi vetëm 25,000.00 € të dedikuara për këtë projekt të cilin ne e kemi përkrahur edhe pse kemi thënë se është i vonuar sepse pas 16 viteve të fillohet me këto projekte prapë e përsërisim se janë të vonuara. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit po ashtu kemi disa projekte të cilat nuk specifikohen e që do të ishte mirë të bëhej një gjë e tillë nga ana e drejtorit përkatës, projekti për rregullimin e infrastrukturës së varrezave në shuma 45,000.00 € do të ishte mirë ta dijmë se ku bëhet ky rregullim i varrezave për arsye se vazhdimisht po përsëritet ky projekt por asnjëherë nuk specifikohet se për cilat vende bëhet fjalë, pastaj për ndërtimin e trotuareve shuma 165,220.00 € nuk janë specifikuar se për cilat vende është fjala edhe përkundër kërkesave tona që të ndërtohen trotualet afër shkollave. Tek Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, projekti nr.1, participimi me donatorë në projekte të ndryshme në shumë 84,000.00 €, a mund ta dijmë ne se për cilat projekte bëhet fjalë, a ka projekte të gatshme apo ndoshta nuk ka projekte fare ose ndoshta bëhet fjalë që vetëm nëse paraqiten projekte të reja, prandaj për këtë çështje është një dallim i madh mes tyre, ne natyrisht e përkrahim zhvillimin, por megjithatë duhet ta dijmë se a ka projekte apo është menduar vetëm nëse vijnë projekte të reja. Te Drejtoria e Administratës nga të hyrat vetanake janë paraparë 120,000.00 € për inventarizimin e objektit të ri të Komunës, unë mendoj se do të mund të kalonte inventari aktual i këtij objekti në atë të riun për një kohë, kur kemi parasysh se për bulevarde dhe për monumente

janë vetëm 10,000.00 €, ndërsa për inventarë në objektin e ri 120,000.00 €, mendoj se është shumë e paarsyeshme kjo. Te Drejtoria e Arsimit janë paraparë 140,000.00 € për zgjerim dhe renovim të objekteve shkollore, mendoj se kjo Drejtori duhet të ketë buxhet më shumë dhe kjo çështje mendoj se është si pasojë e mos komunikimit dhe mos inkorporimit të komisionit të arsimit dhe inkorporimi i shumë sektorëve që do të ndihmonin që Drejtoria e Arsimit të kishte më shumë buxhet që do të ishte shumë më e arsyeshme sepse nevojat dhe kërkesat e shkollave janë të shumta. Duke u nisur nga të gjitha këto ne mendojmë se gjatë hartimit të buxhetit duhet të marrin pjesë qytetarët, duhet të merren parasysh kërkesat e qytetarëve duke dalë në terren dhe duke iu ofruar qytetarëve, andaj ne si Grup kësaj radhe do të abstenojmë, abstenojmë meqë në këtë projekt kemi vendosjen dhe ndërtimin e monumenteve.

z.Flakron Gashi, theksoi, mendoj se brenda një viti seanca më rëndësishme e Kuvendit është ajo sikurse e ngjashme me sot që bëhet votimi ose diskutohet për buxhetin e Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik. Është e vërtetë ajo që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e tha që përveç pagave, shpenzimeve kapitale, më pas mallra dhe shërbime si kategori e tretë me koston më të lartë. Unë nuk do t'i qasem veç e veç projekteve sepse disa prej tyre parafolësit i cekën, mirëpo nuk mund t'i shmangemi disa shifrave të cilat janë diskutabile dhe që qytetarët duhet të jenë në dijeni për to. Nëse i qasemi programeve të organizatës buxhetore sipas radhës, pra kërkesës buxhetore të Zyrës së Kryetarit shihen shifra interesante, madje edhe disa bukur të larta ku kjo Zyrë buxhetit të Komunës për vitin 2017 do t'i kushtoj hiq më pak se 142,211.00 €, ka paraparë madje edhe shumë në vlerë 1500.00 € për pagesë si punë jashtë orarit, nuk e di a është fjala për pagesë për kohën që bënë Kryetari deri sa vjen nga Prishtina në punë dhe pasi ta lërë punën të shkon në Prishtinë sepse siç jemi në dijeni Kryetari Veliu nuk e ka zgjedhur vend për të jetuar Komunën që e udhëheqë. Më pas për shpenzime të udhëtimit dhe për shpenzime të udhëtimit jashtë vendit parashikohen 10,000.00 €, për dreka zyrtare 5,000.00 € shumë kjo e dyfishuar në krahasim me dy vitet e kaluara, mandej për mallra dhe shërbime dhe blerje tjera 25,900.00 €, ndërsa një çështje tjetër që për mua aq sa është qesharake është edhe e pakuptimtë shuma 2000.00 € për furnizim me ushqim dhe pije ku përveç që ka paraparë shumë të mjeteve për dreka zyrtare, është fjala për furnizim me ushqim dhe pije (spitale, burgje dhe çerdhe), nuk e di për çfarë bëhet fjalë por mendoj se Kryetari ose drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave duhet të japin shpjegime për këto shifra. Pastaj te organizata buxhetore, Administrata dhe Personeli, përveç gjërave që i cekën kolegët parafolës, një fakt është për tu shtjelluar, në këtë vit, në vitin 2015 dhe në vitin 2014, në emër të furnizimit për pastrim janë shpenzuar 27,000.00 €, 20,000.00 € dhe 17,000.00 €, ndërsa për vitin 2017 janë kërkuar vetëm 5,000.00 €, pra për vite të tëra ato mjete ose janë keqpërdorur ose për vitin e ardhshëm stafi i Administratës dhe Personelit me këtë shumë të parashikuar në emër të higjienës, me keqardhje e them se do të marrin epidemi, sepse nëse për vitin e ardhshëm parashikohen vetëm 5,000.00 € për mirëmbajtje të pastërtisë, gjë që është e nevojshme, ndërsa në vitet paraprake janë shpenzuar shumë rre 30,000.00 €, këtu diçka qëndron. Te organizata buxhetore për kulturë rini dhe sport, nëse i referohemi buxhetit të kësaj Drejtorie për investime kapitale dhe projekte prioritare dhe nëse analizojmë projektet të cilat janë duke u kryer, kushtimisht e them, dhe shuma e cila është dedikuar për rini për vitin 2016 krijohet bindja që bëhet fjalë për një Komunë shumë të vogël e që nuk dua të përmendi emra sepse dalim tek komunat me shumicë serbe, ndërsa jemi në dijeni se bazuar në statistikat zyrtare të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, bazuar në grup moshën për rini nga moshë 15 deri në 27 vjeçare, Komuna e Podujevës ka mbi 21 mijë të rinj, dhe për këtë vit është një deklaratë e drejtorit të DKRS-së z.Agron Gërguri që Komuna ka ndarë ose paraparë 7,350.00 € e që i bie 34 cent për kokë të një të riu të Podujevës në vitin 2016, kjo është e tmerrshme dhe kjo më së mirë

pasqyron përkushtimin e Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të DKRS-së, por siç duket për drejtorin z.Agron Gërguri dita e mirë fillon atëherë kur e nisë orarin e punës me një gotë viski edhe i duket vetja bilbil kur fol, sikurse që kemi rastin në një seancë paraprake e që sot duhet të shfuqizojmë ato vendime për të cilat edhe ashtu ishim kundër ne si Grup.

z.Bahri Selimi, theksoi, sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore u fol shumë nga parafolësit dhe u jepen vërejtje të cilat vërtetë meritojnë të jepen, mirëpo ajo që mua më ka bërë përshtypje në këtë Kornizë, është shpërndarja e projekteve e që ne edhe më parë kemi thënë se projektet po shpërndahen goxha shumë në baza partiake gjë e cila fillimisht nuk ju ka bërë përshtypje, mirëpo duke nxjerrë disa statistika kjo gjë po vërtetohet dita ditës. Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit shpërndarja e këtij buxheti për 78 fshatra apo zonave rurale që ka Komuna e Podujevës, janë përfshirë 20 fshatra e që i bie 25.6% e buxhetit, andaj nëse mendohet se ky buxhet është shpërndarë mirë dhe korrekt sigurisht se kjo shifër nuk do të dilte. Edhe më keq qëndron kjo çështje te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku edhe në këtë Drejtori nga 78 fshatra sa ka Komuna e Podujevës janë përfshirë vetëm 13 prej tyre e që i bie 16.6% e fshatrave të përfshira në projekte që janë shpërndarë nga Drejtoritë e Komunës në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, pra këto shifra që i japë unë janë për vitin 2017, sepse për vitet 2018-2019 as që i kam marrë për bazë sepse e di që ato do të ndryshohen shumë herë deri te miratimi i tyre, marrë në tërësi për vitin 2017 del se prej 78 fshatrave janë të përfshira 25 fshatra në projekte të ndryshme dhe kjo del se vetëm 32% e fshatrave janë të përfshira në projekte. Nëse ne mendojmë se ka transparencë dhe gjithëpërfshirje në këtë projekt buxhet, atëherë më së miri tregojnë këto shifra të cilat mund t'i verifikoni edhe ju.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH) theksoi, dëgjua diskutimet e këshilltarëve të Kuvendit ku pati vërejtje dhe sugjerime por vërtetë deri tani propozime konkrete nuk pati, dhe kjo do të thotë se ne Ekzekutivi i Komunës ja kemi qëlluar me planifikime. Në vazhdim do të përgjigjem shkurtimisht vërejtjeve, pyetjeve apo sugjerimeve të disa këshilltarëve parafolës, sa i përket shenjëzimit të rrugëve që z.Rafet Llapashtica e ngriti si çështje, përgjigja është se shuma e paraparë prej 35,000.00 € nuk parashihet për tabela të rrugëve sepse ky projekt është donacion i BE-së dhe vetëm pritet fillimi, por ajo shumë parashihet për tjera çështje që kanë të bëjnë me rrugë, pra jashtë atij projekti.

Sa i përket pyetjes së z.Haki Rudarit rreth dy projekteve përkatësisht për varreza dhe për trotuare, disa herë e kemi cekë se DSHPMSH është e obliguar që të ketë projekte dhe kode të përbashkëta, ta zëmë te ndërtimi i trotuareve përfshihen edhe hapësirat afër të gjitha shkollave pothuajse dhe për këtë jemi në procedurë të prokurimit dhe do ta keni edhe informacionin se vetëm ky projekt afër shkollave përfshin mbi 15 fshatra gjë që e mohon tërësisht atë që këshilltari z.Bahri Selimi e tha dhe se ato përqindje që u cekën nuk kanë të bëjnë me këtë dhe nuk është logjike ajo që u cek ngase ka projekte të shumta ku përfshihen disa fshatra, për ndërtim të trotuareve përfshihen mbi 20 fshatra, për rrugë me zhavorr kemi mbi 50 fshatra, për zgjerim të lumenjve janë dhjetëra fshatra, me ndriçim publik është përfshirë një pjesë e madhe e qytetit e të tjera, Do të thotë se gjeografikisht janë përfshirë bukur shumë fshatra prandaj kjo është dhe brengë e jona që të përfshihen të gjitha fshatrat sepse po të punonim ne aq keq siç u tha do të thonim se ju si opozitë e keni mirë, mirëpo jemi kujdesë që të punojmë mirë prandaj edhe e vlerësojmë që ky propozim buxhet është i drejtë. Struktura e buxhetit është e tillë dhe ne këto probleme i kemi theksuar edhe më parë se Komunitat, për fat të keq, nuk mund ta bëjnë ndryshimin e buxhetit për subvencione e që do të ishte shumë normale sikur të ngritej shuma e subvencioneve e posaçërisht në sektorin e bujqësisë dhe ajo për mallra dhe shërbime, andaj kemi qenë të detyruar të veprojmë sipas strukturës së caktuar nga Ministria e Financave, strukturë e cila edhe pse është e pafavorshme

ende për Komunat. Brenda DSHPMSH, vërehet se ka ndryshime sa i përket strukturës ku kryesisht dominon struktura e kanalizimeve prej 26%, pastaj për kolektorë 20%, trotuaret afër 15%, rrugët me zhavorr 13%, për lumenj 10% për ndriçim publik 10%, e të tjera.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), theksoi, gjatë këtyre diskutimeve u mundova t'i marrë të gjitha vërejtjet, kërkesat dhe sugjerimet e parafolësve, andaj në vazhdim do t'i jap përgjigjet e nevojshme. Sa i përket çështjes së vendosjes së tabelave të rrugëve me emra përkatës sipas Vendimit të Kuvendit, është projekt i cili investohet me donacion të Komisionit Evropian sipas të cilit mbështet projekti përkatës dhe mund t'ju njoftoj se ka rreth 10 ditë që ka filluar faza e parë që është vendosja e shtyllave përkatëse, ndërsa sipas njoftimit të Agjencionit Kadastral të Kosovës projekti në tërësi do të përfundoj brenda 4 muajve në gjithë territorin e Komunës së Podujevës. Sa i përket mjeteve të parashikuara në DPUMM si nga grandi Qeveritar dhe nga të hyrat vetanake, mendoj se mund t'i rrumbullakojmë ato investime mirëpo nëse vërejmë se ka mungesë të mjeteve mundemi që me rishikimin e buxhetit të plotësojmë shumat e kërkuara edhe pse është menduar se këto investime kapitale të realizohen në periudhën dy vjeçare 2017-2018. Sa i përket asaj që z.Bahri Selimi e ceku se numri i fshatrave të përfshira për investime është i vogël, mund t'ju them se për investime rëndësi i është kushtuar atyre kërkesave të qytetarëve që janë më emergjente duke marrë dendësinë e popullatës së lokalitetit përkatës dhe pa lënë anash edhe numrin e nxënësve të cilët qarkullojnë në ato pjesë. Mundësia dhe hapësira ekziston që me rastin e rishikimit të buxhetit ose në vitet në vijim të ndryshojnë këto planifikime, mirëpo mendojmë se edhe në planifikimet për vitet 2018 – 2019 janë përfshirë numër i madh i fshatrave në të cilat do të ketë investime të ndryshme.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), dhe i autorizuar për ushtrimin e të gjitha kompetencave të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik (DPZHE), theksoi, edhe pse drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e bëri sqarimin e nevojshëm për dy projektet e fundit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, dëshiroj të përsërisë edhe unë atë se projektet numër 5 dhe 6 përkatësisht ndërtimi i shtigjeve për biçikleta tek parku i qytetit dhe projekti për ndërtimin e shtigjeve tek pishat e fshatit Kërpimeh, janë shkruar në projektin numër 5, studimi i fizibilitetit për pronat komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim për nevoja ekonomike, si dhe vlera tjetër financiare e mbetur është bartur në dy projekte tjera në kuadër të Drejtorisë.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit për përgatitjen e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2018 – 2019, projektbuxhet i përgatitur në bazë të legjislacionit në fuqi, në radhë të parë drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave me stafin e Drejtorisë përkatëse dhe të gjithë kontribuuesit tjerë në këtë proces. Po ashtu e vlerësoj pjesëmarrjen e qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjime buxhetore të mbajtura në lokalitete të ndryshme në Komunën e Podujevës. Gjithashtu sa i përket këtij procesi, nuk mund të anashkaloj pa e falënderuar edhe OSBE-në për ndihmën dhe lehtësimin që e bëjnë për vite me radhë.

Sa i përket çështjes së shpërndarjes së mjeteve, që u përmend Zyra e Kryetarit, vetëm dëshiroj t'ua rikujtoj se në bazë të organogramit të Komunës së Podujevës, në kuadër të Zyrës së Kryetarit, përfshihen; Zyra për marrëdhënie me publikun dhe Informim, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyra për të drejtat e Njeriut ku përfshihen lëmit e të drejtave të fëmijëve dhe barazia gjinore, dhe Zyra për integritet evropiane, pra nuk bëhet fjalë që shuma e cekur e mjeteve buxhetore është ndarë vetëm për Kryetarin e Komunës. Sa i përket shpenzimeve të mia në cilësinë e Kryetarit të Komunës, cili do që është i interesuar, mund ta shoh në raportet e deritanishme të auditimit, dhe nuk besoj se do ta ndryshoj këtë kurs. Jeni në dijeni se Komuna e Podujevës është

më e madhja për nga territori dhe në mesin e Komunave më të mëdha me numër të banorëve, ndërsa renditemi në mesin e Komunave më të vogla sa i përket shpenzimeve të Zyrës së Kryetarit. Dëshiroj t'ju siguroj edhe një gjë, nuk kam të ardhura tjera nga Buxheti i Republikës së Kosovës, përveç pagës time në cilësinë e Kryetarit të Komunës gjë të cilën mund ta vërtetoni kushdo që ka dëshirë, kështu që mos e keni atë brengë që ajo shumë e mjeteve është për punë shtesë sepse asnjëherë nuk marr asnjë cent për punë shtesë dhe nuk besoj që do të marrë në të ardhmen, e them këtë ngase unë i di punët e mia, mirëpo në këtë drejtim do t'ju sugjeroja juve që ta shikoni vetveten dhe secili prej jush t'i shihni edhe pagat e juaja, ku jeni të punësuar, ku merrni, çfarë bëni e të tjera, pra pastrohuni ju në radhë të parë. Sa i takon jetës time private, unë jam qytetarë i lirë i Kosovës së lirë dhe jetoj bash ku të dua, shkoj bash kah të dua, por edhe pse jam në dijeni se punoni nëpër zyre të atyre shokëve që ndoshta ju porosisin ndonjëherë, ju këshilloj të mos më përcjellni se nuk ju shoh, ama bash nuk ju shoh, dhe krejt puna ju shkon huq - kot, kështu që mos më përcjellni, jetojeni jetën e juaj dhe punojeni punën e juaj, unë jam i lirë, lëvizi lirshëm dhe kur është nevoja lëvizi lirshëm edhe vetëm, kështu që po e ripërsëris, mos më përcjellni sepse nuk ju shoh dhe vetëm ju shkon koha kot.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Kryetari i Komunës në diskutimin e tij më shumë e orientoj temën nga Grupi jonë i këshilltarëve, mendoj se Kryesuesi i Kuvendit e ka obligim ligjor të drejtoj seancën konform rendit të ditës. Dokumenti dhe projeksionet përkatëse janë proceduar në Kuvend për miratim, ndërsa ne si këshilltarë të Kuvendit jemi ata të cilët e miratojmë ose jo. Unë personalisht nuk kam dëshirë dhe nuk jam pasionist të merrem me gjërat që Kryetari i Komunës i ceku përkatësisht me punën private të askujt sepse ne jemi persona zyrtar, dhe për punën zyrtare është e drejtë e çdo kujt të gjykoj dhe të jap vërejtje për secilin, kurse për punën private jo Kryetar. Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, individualisht ose privatisht mundet, por në Kuvend nuk është për ta përcjellë askënd dhe nuk e kemi atë detyrë, këtë e ndjejë për obligim t'ju them. Ndërsa për obligimet ligjore si Kryetar i Komunës dhe i ndonjë drejtori siç ishte rasti i drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i cili në Kuvend sjellë projekt në interes të Podujevës, ne i kemi dhënë mbështetje, mirëpo për ata drejtor të cilët nuk i kryejnë punët e tyre asnjëherë të mos mendojnë që për teke të ndokujt ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së do të mbështesim diçka. Ne kemi ofertuar me programe dhe qeverisje të ndryshme dhe gjërat i shohim ndryshe secili subjekt politik. Vërejtjet të cilat janë për Ekzekutivin e Komunës direkt ju takojnë drejtorëve të Drejtorive por edhe juve si Kryetar i Komunës sepse drejtorët e Drejtorive nuk po mund të na japin përgjigje, andaj në këtë aspekt konsideroj se është mirë që pas kësaj mbledhjeje ju si Kryetar i Komunës duhet t'i pyesësh drejtorët përse nuk mund ta lirojnë pronën publike dhe përse një zyrtar i juaji mban një pronë të uzurpuar. Absolutisht është e vërtetë që secili qytetarë ka të drejtë të zgjedh ku dëshiron të jetoj, mirëpo sa i përket qeverisjes janë disa rregulla ligjore të cilat duhet të respektohen, e që mendoj se Kryetari i Komunës është në dijeni sepse ka një përvijë në këtë aspekt. Konsideroj se ne këshilltarët e Kuvendit më së paku kemi punë me Kryetarin e Komunës, por puna jonë është me Kuvend dhe me akte të Kuvendit, mirëpo Kryesuesi i Kuvendit shpesh sillet si të ishte pjesë e Ekzekutivit, andaj kërkoi nga ai që seancat t'i orientoj ashtu si duhet e jo t'i personalizoj gjërat. Sa i përket fjalimit paraprak të Kryetarit të Komunës, mendoj se u ngut pak sa, edhe pse nuk e di qëllimin e tij, por nuk ishte ashtu siç u shpreh ai.

z.Flakron Gashi, theksoi, mora fjalën specifikisht për ju zotëri Kryetar i Komunës, unë jam asambleist dhe bazuar në rregullat në fuqi për zgjedhjet në nivelin lokal, unë kam marrë mandatin për të përfaqësuar interesat e qytetarëve dhe banorëve të Komunës së Podujevës. Unë kam zgjedhur vendin të jetoj aty këndë e përfaqësoj. Zotëri Kryetar, unë juve nuk ju përcjellë personalisht, dhe ju si Kryetar kurrfarë vlere për mua nuk keni, bash hiq kurrfarë. Kohë të gjatë ju

para kolegëve të juaj partiak e luani rolin e viktimës, ndërsa ata të cilët ju pretendoni më duket se ti i ke më dosta dhe takohesh më shpesh se sa unë, por mos e luaj rolin e viktimës para asamblistëve këtu. Shpenzimet të cilat ju i bëni me veturën zyrtare çdo ditë nga Podujeva në Prishtinë dhe anasjelltas, sepse nuk ke zgjedhur të jetoni në Komunën e Podujevës, të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës të cilët punojnë në Prishtinë, për shkak se nuk ka kushte dhe ata nuk mund ta gjejnë vetën në Podujevë, ju shohin në çdo mëngjes duke ardhur me veturë zyrtare dhe duke shkuar kur ta kryesh orarin e punës, prandaj këto hynë në shpenzime të buxhetit të kësaj Komune, dhe ne thirremi për të mbrojtur keqpërdorimet e kësaj fushe.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, kërkoj nga të pranishmit që gjatë debatit të kenë kujdes sa i përket vlerësimeve për të tjerët. Në vazhdim theksoi, konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa u janë shpërndarë të gjithëve sipas së cilës ky projekt buxhet i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, gjithashtu pjesë e këtij dokumenti është edhe propozim Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017 për të cilën drejtori përkatës në fjalën hyrëse i ceku sqarimet e nevojshme, andaj e hedh në votim propozim buxhetin e Komunës për vitin 2017 dhe parashikimet për 2018-2019 së bashku me propozim Rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, asnjë votë kundër, dhe 13 vota të përmbajtura, u miratua propozim buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018 – 2019, duke përfshirë edhe propozim Rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës së Podujevës për vitin 2017, si pjesë përbërëse e buxhetit.

4. Propozimi i Vendimit për lejimin e mjeteve buxhetore për realizimin në bashkëfinancim të projektit "Ngritja e përkujdesit shtëpiak dhe ambulantor (Home Care) në Komunën e Podujevës"

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa këtë propozim vendim e kemi përkrahur njëzëri dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, propozim për të cilin kemi vlerësuar se është në interes të Komunës ngase me 17% të mjeteve buxhetore sa parashihen për këtë projekt, Komuna mund të realizojmë atë, dhe sigurisht se do të jetë i mirëseardhur për banorët e Komunës së Podujevës. Nëse nuk këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim.

5. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2016 / 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se në planin e punës së Kuvendit për vitin 2016 janë paraparë dy informata të Drejtorisë së Arsimit sa i përket fillimit dhe përfundimit

të vitit shkollor si dhe çështjeve tjera nga fusha e arsimit. Informata a parë është paraqit para Kuvendit në një seancë të mëparshme kurse tani kemi edhe informatën e dytë për të cilat e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për sjelljen e tyre me kohë. Vlen të theksohet se informata përkatëse ju është dërguar me kohë dhe keni pasur mjaft kohë për të analizuar, por si do që të jetë unë hepi diskutimin rreth kësaj pike, por fillimisht nëse drejtori ka sqarime dhe informata shtesë ftoj të marr fjalën.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, meqë informata është dërguar para rreth shtatë ditësh unë shoh të arsyeshme të jap edhe informata plotësuese sepse ndërkohë kanë lëvizë disa gjëra, fjala është për SHFMU "Enver Maloku" në të cilën nuk ka filluar procesi mësimor me kohë. Drejtoria e Arsimit ka qenë në kontakt të përhershëm me këshillin drejtues të shkollës, me këshillin e prindërve, me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) si dhe me gjithë akterët tjerë të involvuar në këtë çështje. Përfundimi është se MASHT-ti përmes një shkrese ka premtuar që më 01.11.2016 objekti i ri i shkollës së cekur do të lirohet përkatësisht do të vihet në funksion, ne jemi në pritje të funksionalizimit të atij objekti, mirëpo në pajtim me prindërit e nxënësve të asaj shkolle, për nxënësit e kl. I-rë deri në kl.V-të kemi bërë zgjidhje të përkohshme që këta nxënës të vijojnë mësimin në objektin e SHFMU "Shaban Shala", ndërsa më së largu deri nesër do të bëhet edhe një zgjidhje tjetër e përkohshme për nxënësit e klasëve tjera deri sa MASHT të përfundoj me objektin e ri të shkollës së cekur. Prandaj edhe mora fjalën me qëllim që t'ju informoj rreth shkollës së cekur sepse në informatën e dërguar është tjetër opinion rreth kësaj çështjeje. Gjithashtu çështje tjetër e cila nuk figuron në informatën e dërguar, ka të bëjë po ashtu me objektin e SHFMU "Enver Maloku", objekt i cili ka filluar të ndërtohet në vitin 2008 nga MASHT-ti, dhe në një formë është bërë histori në vete, por megjithatë ne si Drejtori mendojmë se tani është fundi dhe ai objekt shumë shpejt do të përfundoj dhe do të funksionalizohet.

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës nuk ka investuar në objektin e vjetër të asaj shkolle për arsye se kemi vlerësuar se në objektin e ri ka shumë pak punë për tu liruar dhe funksionalizuar për mbarëvajtje të procesit mësimor. Më 12.09.2016 këshilli drejtues i shkollës ka marrë një vendim të njëanshëm ku ka tentuar të hyjë në objektin e ri të shkollës së cekur, mirëpo të nesërmen po ai këshill është tërhequr nga ai vendim sepse ka vlerësuar se është i gabuar.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, për gjendjen reale të arsimit në Komunën e Podujevës në përgjithësi, jemi në dijeni të gjithë besoj se si është. Ajo që vlen të theksohet si gjendje e rëndë është shkolla "Enver Maloku" ku pjesë e asaj lagjeje jam edhe vetë unë. Lidhur me objektin në fjalë Kryetari i Komunës z.Agim Veliu, shumë herë i është drejtuar me kërkesa Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për përshpejtim të procedurave në mënyrë që objekti i ri i shkollës së cekur të përfundoj dhe të funksionalizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, gjë të cilën MASHT-ti asnjëherë nuk ka ndërmarr veprime të tilla në funksion të rregullimit të atij objekti, andaj si pasoj e kësaj edhe sot nxënësit e asaj shkolle janë jashtë procesit mësimor, mirëpo drejtori parafolës tani na njoftoj se kanë filluar me disa procedura për gjetjen e hapësirave të nevojshme që përkohësisht ata nxënës ta vijojnë procesin mësimor.

Duke qenë në dijeni për rëndësinë e edukimit të nxënësve dhe përgatitjes së tyre për të ardhmen e vendit, unë personalisht, kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit që ta ketë një përkushtim edhe më të madh sa i përket arsimit në Komunën e Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne po debatojmë për arsimin në Komunën e Podujevës, mirëpo ashtu sikurse në mbledhjen KPF-së edhe sot në këtë mbledhje drejtori i Drejtorisë së Arsimit krejt temën po e fokuson në një objekt shkollor, e që ka edhe shumë shkolla të tilla ku nuk zhvillohet mësimi fare. Mendoj që nëse stafi arsimor ka qenë në pushim verorë për rreth 3 muaj, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës nuk ka qenë në pushim dhe ka mund të bëjë përgatitjet e

nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor. Gjendje e tillë nuk është vetëm në këtë fillim vit, unë jam në dijeni se drejtori i DA edhe sot me datën 26.09.2016 nuk i ka të gjitha orët e shpërndara dhe i mban pezull ashtu, po ashtu jam në dijeni se ka mësimdhënës me shkollë të mesme të cilët japin mësim në shkollat Komunës së Podujevës, jam në dijeni se edhe në shkollat tjera ka nxënës të cilët kurrë nuk e zhvillojnë një orë të mësimi që është me plan program, jam në dijeni se shumë shkolla në Komunën e Podujevës nuk kanë ujë të pijshëm për nxënës, jam në dijeni se ka shumë shkolla në Komunën e Podujevës ku shumë nxënës detyrohen që gjatë orarit të mësimi të shkojnë në shtëpitë e tyre për të kryer një shërbim tualeti, por jam edhe në dijeni se drejtor i Drejtorisë së Arsimit nuk mund të zgjidh çështjet apo problemet që ka arsimit në Komunën e Podujevës sepse nuk menaxhon dhe nuk bashkëpunon as me nivelin qendrorë, as me qeverisjen lokale - këtu dhe as me qytetarë. Mendoj se forma më e mirë për të zgjidhur këto probleme do të ishte sikur drejtori z.Avni Maloku të dorëhiqet prej këtij pozicioni dhe të emërohet një drejtor tjetër, natyrisht nga LDK-ja, jo nga subjektet opozitare sepse nuk po e kërkojmë një gjë të tillë ngase jemi në dijeni për rregullat e qeverisjes dhe ato të demokracisë, mirëpo drejtori aktual si profil nuk mund t'i zgjedh këto probleme. Nuk ka kuptim që sot në vitin 2016 nxënësve tanë t'iu mbahen ligjërat nga mësimdhënës me shkolla të mesme e pastaj ata nxënës të kenë probleme në regjistrim të niveleve më të larta arsimore, unë nuk dëshiroj të përmend emra të mësimdhënësve të tillë mirëpo drejtori është në dijeni shumë mirë për këtë sepse ka të atillë në shkollën "Luigj Gurraquqi" në shkollat e fshatrave Gërdoc dhe Batllavë etj. Po ashtu nuk ka arsye drejtori z.Avni Maloku që në shkollën e fshatit Batllavë, nxënësit nga kl. I – V-të mos ta mbajnë asnjë orë të mësimi të edukatës fizike dhe përgatitjes së kulturës apo edhe të mos kenë tualete e as ujë të pijes në shkollën e tyre. Mendoj se drejtori është dashur të ndërmer masa konkrete dhe të sjellë rekomandim për buxhet shtesë në Kuvendin e Komunës në mënyrë që ne si Kuvend ta miratonim atë buxhet dhe të rregulloheshin gjërat, pa dyshim se Grupi i këshilltarëve të PDK-së do ta mbështeste rritjen e buxhetit për arsim për krijimin e kushteve për zhvillim normal të mësimi, mirëpo drejtori ka sjellë propozim vetëm shumë e mjetëve 140,000.00 € me të cilat ka ndërtuar vetëm garazha dhe objekte ndihmëse për dru në shkolla të ndryshme, kurse nuk janë bërë renovime në shkolla të ndryshme ku po thuajse nevojat kanë qenë urgjente, gjë të cilën drejtori nuk mund ta mohon tani, apo nëse mund, i kërkoj ta merre fjalën dhe të tregon se në cilën shkollë është bërë renovimi, apo nëse mund të garantoj se deri në fund të këtij mandati, nuk do të japin mësim më, mësimdhënën me shkollë të mesme. Po ashtu mendoj se drejtori ja ka humb vlerën edhe diplomave, edhe profesorëve, edhe fakulteteve por dhe nxënësve të cilët diplomojnë, për arsye se nuk mund të jep mësim asnjë kuadër i përgatitur, për shkak se drejtori i ka diskriminuar politikisht, i ka diskriminuar të gjithë fëmijët e qytetarëve të cilët nuk kenë ujë të pijes në shkolla dhe detyrohen t'i mbushin tjetër kund, dhe i ka diskriminuar duke mos iu krijuar kushte për një shërbim në tualet. Andaj për këto arsye unë kërkoj të dorëhiqet nga kjo detyrë drejtori në fjalë dhe njëkohësisht kërkoj nga Kryetari i Komunës që në të ardhmen ta emëron një drejtor të Drejtorisë së Arsimit i cili e njeh fushën e arsimit. Mendoj se në këtë Kuvend nga të gjitha subjektet politike ka shumë këshilltarë të cilët pajtohen me deklarin tim, mirëpo për shkaqe politike nuk prononcohen, atëherë le të mbetet në ndërgjegjen e secilit këshilltarë të Kuvendit nga profili i arsimit që ta ngritë dorën dhe të merre fjalën dhe të debatohet për arsimin në Komunën e Podujevës, si për të mirë si për të keq, sepse të gjithë ne kemi dalë në fushata elektorale dhe kemi thënë se do ta ndryshojmë këtë çështje, kurse gjendja e arsimit që tri vite të këtij mandati është vetëm më e keqe se sa që ka qenë në vitin 2013, kurse për kohën e mbetur në këtë mandat mendoj se me një drejtor tjetër do të ndryshonte për të mirë. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në çdo seancë ankohet për gjendjen në të cilën gjendet arsimit, mirëpo ai është drejtor dhe duhet të merrë vendime të ndryshme në mënyrë

që gjendja të ndryshoj. Vlen të theksohet që nga emërimi i drejtorit z.Avni Maloku, asnjëherë deri tani nuk është sjellë asnjë propozim në Kuvend për rritje të buxhetit të arsimit në funksion të përmirësimit të gjendjes aktuale, mundësitë kanë qenë nga buxheti i të hyrave vetanake në mënyrë që të rregullohet çështja e tualeteve dhe ujit të pijes, mirëpo drejtori ka zgjedhur vetëm një rrugë ku sjellë informata dhe ankohet për gjendjen e keqe, mirëpo ne nuk mund ta zgjedhim atë. Ne si Grup kemi vërejtje edhe për Drejtoritë tjera, mirëpo përveç, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Inspeksionit të cilat nuk kanë bërë asgjë, të tjerat diçka kanë bërë, do të thotë, asnjë pronë nuk është liruar në këtë mandat, asnjë denoncim nuk është bërë në Gjykatë, asnjë shkollë nuk është stabilizuar njëherë e përgjithmonë në këtë mandat, asnjë zhvillim ekonomik, aspak nuk është zvogluar papunësia në Komunën e Podujevës, e as nuk është rritur buxheti në këtë Komunë. Mendoj se këshilltarët e Kuvendit që janë mësimdhënës mund ta analizojnë bashkërisht me drejtorin e DA-së gjendjen aktuale të arsimit, mirëpo mendoj se asnjë mësimdhënës nuk është i kënaqur me gjendjen aktuale sepse drejtori aktual e ka sjellë arsimin në një gjendje shumë kritike, tmerrësisht të keqe, mund të them 50% më keq se sa që kur ka qenë drejtori i kaluar. Pra drejtori është dashur të rregulloj problemet në arsim duke përfshirë edhe rregullimet e objekteve si, tualete, ujë të pijes e të tjera, nëse nuk ka pasur mjete është dashur të sjellë në Kuvend kërkesë për buxhet shtesë në mënyrë që renovimet në objektet shkollore të kryhen me kohë, e jo vetëm të ankohet në Kuvend dhe me informata të tilla se kjo Drejtori ka mungesë të buxhetit.

z.Bahri Selimi, theksoi, duke u bazuar në disa kërkesa të mëhershme që ne Grupi nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje i kemi bërë, në mënyrë që ne si Kuvend të njoftohemi për punën e drejtorëve të Drejtorive të Komunës, ne tani kemi marrë një informatë nga Drejtorja e Arsimit për fillimin e vitit shkollorë 2016/2017. Në dorë kemi një dokument i cili më shumë ngjan në një referat të klasës së pestë me titull, shkolla e mesme "Enver Maloku", se sa një informatë për arsimin në tërësi. Më shumë se 80% e këtij dokumenti flet për shkollën "Enver Maloku", mirëpo këtë e shohim në rregull sepse për këtë shkollë ka çka të flitet mjaft duke u bazuar në gjendjen e krijuar në të, shkollë në të cilën nuk filluar procesi mësimor edhe një muaj pas afatit të fillimit të vitit të ri shkollor, kurse në informatën e Drejtorisë së Arsimit thuhet që prindërit e nxënësve të asaj shkolle janë të pakënaqur me kushtet që i ofron objekti i vjetër shkollor, mirëpo ne i themi drejtorit se, jo që prindërit janë të pakënaqur por ata nuk kanë pranuar fare të filloj procesi i mësimin në atë shkollë, deshët ju apo nuk deshët. Gjithashtu në këtë informatë thuhet që edhe ju si Drejtori potenconi se objekti i shkollës së cekur nuk i plotëson kushtet optimale për zhvillimin e mësimin, a thua drejtor kush na qenka fajtor për këtë gjendje të krijuar në atë objekt shkollor, madje madje nuk jam në dijeni se a ka bërë vizita drejtori edhe në shkolla tjera sepse gjendje e tillë është edhe në shumicën e shkollave në Komunën e Podujevës, mirëpo është përqendruar vetëm në një shkollë duke dashur të shpërqendron vëmendjen nga shkollat tjera të cilat pothuajse gjendjen e infrastrukturës e kanë të njëjtë. Më parë jeni arsyetuar se Qeveria e Kosovës nuk po e mbështetë Komunën e Podujevës në ndërtimin dhe rregullimin shkollave me arsyetim se ata janë PDK, kurse ne jemi LDK, tani unë kam pyetje, çka janë ata e çka jeni ju, sa jemi në dijeni tani edhe ju edhe ata janë LDK. Pastaj në këtë informatë potenconi se nga viti 2009 jeni në pritje të përfundimit të objektit të ri shkollor i cili ende nuk ka përfunduar, por i nderuari drejtor, nga ajo kohë janë bërë shtatë vite që ju nuk keni bërë zgjidhje për mbarëvajtjen e mësimin në këtë objekt, madje deri para dy viteve ju keni qenë drejtor i shkollës "Enver Maloku" edhe keni pasur qasje të drejtpërdrejtë me këtë shkollë. Në një paragraf tjetër keni thënë, pas vizitës që kemi bërë së bashku me Kryetarin e Komunës me datën 05.09.2016 në shkollën në fjalë, bashkërisht me prindërit e nxënësve të asaj shkolle kemi marrë vendim që mos të filloj procesi mësimor për shkak se objekti nuk i plotëson

kushtet elementare për mësim dhe si i tillë paraqet rrezik për shëndetin dhe jetën e nxënësve, andaj a jeni në dijeni ju drejtor se çka do të thotë rrezik për jetën e nxënësve, apo vetëm e keni përdorë si shprehje ashtu koti një objekt shkollor i cili paraqet rrezik për nxënës dhe të mbahet i tillë për shtat vite me radhë deri në momentin kur prindërit e nxënësve kërkojnë që të ndërpritet mësimi në atë shkollë. Në paragrafin tjetër thuhet, Kryetari Veliu ka përdorur të gjitha mundësit e tij për të komunikuar dhe ka bërë presion tek MASHT-i, mirëpo kërkesat tona nuk janë marrë parasysh dhe tani ndodhemi në këtë gjendje, lidhur me këtë pak po ndjejë keqardhje për Kryetarin që nuk e paskan marrë parasysh Qeveria qendrore që shtat vite, madje as Kryeministri dy vitet e fundit i cili është i subjektit të tij politik. Në fund të informatës thuhet që Drejtorja e Arsimit duhet të rishikoj Udhëzimin e ri Administrativ nr.19/2016, mirëpo a jeni në dijeni ju drejtor se Drejtorja e Arsimit nuk ka mundësi e as shanse ta rishikoj një Udhëzim Administrativ por është e obliguar të punoj konform Udhëzimeve të cilat nxjerrën nga Qeveria.

Lëvizja Vetëvendosje ka bërë një kërkesë për shfrytëzimin e objekteve shkollore më datën 16.07.2016 me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve të brendshme, ndërsa ju drejtor keni dhënë përgjigje si vijon, Drejtorja e Arsimit e Komunës së Podujevës, pas shqyrtimit të kërkesës për organizimin e aktiviteteve tuaja më 16.07.2016, dhe duke u bazuar në punët që janë duke u kryer në objektet shkollore të Komunës së Podujevës gjatë kohës së pushimeve verore, kërkesa juaj nuk miratohet, arsytimi si vijon, objektet shkollore të Komunës së Podujevës gjatë kësaj periudhe kohore janë në proces të dezinfektimit dhe derratizimit, andaj pyes drejtorin, a po del tani që kjo përgjigje e juaja paska qenë komplet gënjeshtër sepse asnjëherë në këto shkolla si duket nuk qenka bërë dezinfektim dhe derratizim ndërsa për renovim as që bëhet fjalë ngase vetë gjendja e tyre tregon këtë. Përveç këtyre ju keni informuar se pranimi i kuadrit mësimor për këtë vit shkollor është bërë gjatë muajit gusht sipas konkursit të shpallur nga Drejtorja e Arsimit e Komunës së Podujevës, ndërsa unë mendoj se drejtori ka qenë mirë t'i informoni për mënyrën se si keni pushuar nga puna përmes telefonit dy edukatore të mësimit parafillorë dy javë pasi ka filluar procesi i mësimit. Duke u bazuar në Ligjin e Punës 03/L-212, neni 71 paragrafi 1.1, thuhet, punëtori duhet të njoftohet me shkrim 30 ditë kalendrike para se t'i shkëputet kontrata e punës, ndërsa ju drejtor i keni njoftuar dy javë pasi kanë filluar mësimin si mësimdhënëse, prandaj duhet të jeni në dijeni se ju keni bërë shkelje ligjore përkatësisht ligjin e punës në fuqi. Madje ju drejtor që një muaj keni lënë rreth 1000 nxënës jashtë bankave shkollore, dhe që mendoj se kjo gjendje do të vazhdoj edhe më gjatë, si dhe po ashtu keni lënë edhe rreth 150 nxënës pa regjistruar në shkollat e mesme. Përveç njoftimit rreth shkollës "Enver Maloku" që është në këtë informatë, është dashur të njoftohemi edhe; -sa nxënës kanë filluar mësimin, -a janë shkollat të pajisura me mjete dhe cilat prej tyre nuk janë dhe që nuk kanë pasur mundësi të pajisen, -përse shkollat nuk kanë përfunduar së rinovuar, -përse pothuajse gjysma e maturanëve nuk e kanë kryer testin e maturës, -ku qëndron problemi për rënien e cilësisë në arsim, -sa mësimdhënësit japin mësim me kualifikim të mesëm, dhe çështje të tjera. Ne jemi të vetëdijshëm se posti i juaj drejtor, është post politik dhe ju jeni emëruar nga Kryetari i Komunës, por mbi të gjitha drejtor, dorëheqja është akt moral po që se nuk jeni në gjendje të kryeni punët ashtu siç jua përcakton ligji, prandaj ne Lëvizja Vetëvendosje mendojmë se dorëheqja e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit apo shkarkimi i tij nga ana e Kryetarit të Komunës e shpëton arsimin në Komunën e Podujevës, andaj për të ngritur cilësinë e arsimit në Komunën tonë, dorëhiquni drejtor.

z.Flakron Gashi, theksoi, ne kemi pranuar informatën e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe shpeshherë informatat e juaja tregojnë ose pasqyrojnë qasjen që ju keni ndaj arsimit në Komunën e Podujevës, kolegët me të cilët punoni, dhe përgjithësisht të gjithë nxënësit. Çështjes së shkollës "Enver Maloku" unë druaj se shpeshherë i është dhënë ngjyrim politik ose me tendencë politik,

është e vërtetë ashtu edhe siç është pasqyruar se gjendja është jo e mirë dhe mendoj se ndoshta kanë pasë të drejtë prindërit e nxënësve që e kanë marrë atë vendim, por meqenëse ka qenë gjendja kaq e vështirë, përse drejtor keni pranuar pozitën dhe përse keni mbajtur pozitën e drejtorit të asaj shkolle në ato kushte të vështira, nëse ti nuk ke përgjigje, unë të tregoj, sepse pozita juaj e asaj kohe ty drejtor ta ka mundësuar që, dhe në ato kushte, ta punësoni vajzën tuaj pa konkurs. Sa e papërgjegjshme është Drejtoria e Arsimit në Podujevë dhe ju si drejtor, tregon edhe fakti që deri një javë para se të filloj procesi mësimorë nuk e keni ditur ose nuk keni dashur të dini se të mungojnë 900 ditare për 900 paralele, ku 900 mësimdhënës brenda ditës kanë shkuar në mësim me duar në xhepa, sepse kushtimisht e them që ju drejtor jua keni obliguar, të cilëve iu është dashur që nëpër fletë dhe fletore të ndryshme të marrin shënime të ndryshme, dhe kjo është papërgjegjësi e juaja drejtor. Jemi në dijeni se arsimit mesëm nuk është obligativ, mirëpo për shkak të specifikave, Komuna e Podujevës i mbulon shpenzimet për libra të nxënësve të komunitetit ashkalinj, por deri dy ditë para se të filloj procesi mësimorë nuk keni shpallë ofertën që të ketë furnizues dhe të aplikojnë për tender. Në 12 objekte shkollore do të punohet për 60 ditët e ardhshme ku sigurisht se procesi mësimorë do të pengohet, çështje që edhe në storjen e përgatitur dhe transmetuar nga një televizion para disa ditësh, drejtorët e shkollave shprehen shqetësues se procesi mësimorë ka gjasa të pengohet. Për këto dhe shumë përgjigje tjera besoj që drejtori nuk do të përgjigjet në këtë seancë dhe as në seancat tjera, e që njëkohësisht edhe në seancën e kaluar kamë kërkuar përgjigje se a do të ketë transparencë sa i përket shpalljes së konkursit, a janë shpallur të gjitha vendet, kush mban mësim dhe a janë duke mbajtur ende juristët lëndën e muzikës, artit dhe të ngjashme, mirëpo ju drejtor jeni duke pritur përfundimin e kësaj seance dhe pastaj të vazhdoni me ato trikat e juaja siç dini, mirëpo ne i kemi të gjitha informatat dhe me kohë do t'i publikojmë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Arsimit vetëm po akuzohet nga disa parafolës, mirëpo unë kam njohuri dhe e kam vërejtur se drejtori në fjalë ka një angazhim permanent, andaj nuk mendoj se është mirë që gjithherë vetëm të kritikohet sepse nuk është e lehtë të udhëhiqet një Drejtori me rreth 24000 nxënës dhe me një numër të madh të mësimdhënësve dhe stafit tjetër arsimor, mirëpo është çështje e juaja dhe secili prej jush ka të drejtë të diskutoj.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, falënderoj këshilltarët parafolës të cilët po kërkojnë që unë të dorëhiqem, mirëpo unë dorëhiqem atëherë kur të më tërheqë ai që më ka emëruar dhe nuk keni nevojë të merreni me këtë problem, por problemi është se duhet të sqarohen disa çështje të cilat faktikisht edhe njëherë në këtë seancë e kam thënë, dhe i drejtohem prapë këshilltarit parafolës z.Flakron Gashi, por edhe këshilltarit tjetër z.Bahri Selimi, se asnjë arsimtarë me përgatitje ose shkollë të mesme nuk punon në shkolla të Komunës së Podujevës, gjë të cilën e kam thënë edhe më parë dhe po ashtu e them edhe tani. Gjithashtu dëshiroj të ndalem edhe tek çështja e edukatoreve, asnjë edukatore nuk ka mbetur pa punë dhe asnjë edukatore nuk i është shkëputur marrëdhënia e punës, edukatore të cilat ju janë nënshtruar Udhëzimi të ri Administrativ nr.19/2016 sipas të cilit ka ndryshuar raporti edukatore – nxënës që ka qenë nga 12 nxënës në dy grupe, gjithsej 24 nxënës ka pas një edukatore, e që nënkupton zvogëlim të numrit të paraleleve. Tani kemi qenë të detyruar që të gjitha edukatore të cilat profesionalisht janë të kualifikuara për edukatore, t'jua mundësojmë të kenë grupet me numër më të madh të nxënësve, përkatësisht nga 18 nxënës në dy grupe, që i bie gjithsej 36 nxënës. Pra ky ndryshim është bërë duke zbatuar Udhëzimin e ri Administrativ, jo ne si Drejtori. Qëndrueshmëria e edukatores në shkollë është 5 orë, plus 1 orë përgatitje dhe që është e obligueshme që secila edukatore t'i ketë 36 fëmijë në dy grupe pune, ndërsa gjendja në të

kaluarën me ish Udhëzimin Administrativ ka qenë ndryshe ku raporti përkatës është rregulluar nga 12 nxënës në dy grupe, gjithsej 24 nxënës për një edukatore, prandaj detyrimisht është dashur ta korrigojmë gjendjen reale dhe si pasojë e kësaj fatkeqësisht kanë mbetur 7 punëtorë/e, jo që ne jua kemi shkëputur marrëdhënien e punës por nuk iu është vazhduar marrëdhënia e punës sepse nuk kanë pasur nxënës – grupe dhe nuk kanë qenë me kualifikim përkatës. Pra mos të jepen ngjyrimet politike sa i përket kësaj çështjeje sepse 7 edukatorët përkatës vijnë nga të gjitha subjektet e ndryshme politike, madje nëse dëshironi përgjigje politike, ju përgjigjem se pesë nga ato janë të subjektit LDK, një është nga PDK dhe një është nga LVV, mirëpo të mos trajtohet ky problem në mënyrë politike ngase unë nuk i trajtoj në atë mënyrë, por unë do të përpiqem ta trajtoj në atë mënyrë që për të gjitha ato edukatore, të cilat vërtetë kanë punuar një kohë të gjatë, do të mundohem të krijoj kushte që të njëjtave t’jua gjejë vendet e punës konform kualifikimeve përkatëse që kanë, dhe këtë gjë unë para tyre e kam marrë përsipër.

Sa i përket çështjes së regjistrimit të nxënësve, jua them se asnjë nxënës i klasës së IX ose semimaturantë në Komunën e Podujevës që ka përfunduar atë, nuk ka mbetur pa regjistruar dhe të gjithë janë në shkollë. Gjithashtu sërish më duhet të jap edhe disa sqarime rreth objektit të shkollës "Enver Maloku", objekt i cili realisht nuk është i dedikuar për këtë shkollë, por që ka mbetur peng i regjistrimit me vonesë të një numri të nxënësve në Gjimnazin "Aleksandër Xhuvani" sepse objekti ku aktualisht është Gjimnazi nuk plotëson kushtet për numrin e madh të nxënësve që është aktualisht dhe që ka qenë vitin e kaluar rreth 2003, mirëpo është normale që ne duhet t’ju krijojmë kushte atyre, dhe në funksion të kësaj, në bashkëpunim me shkollat tjera ne kemi gjetur zgjidhje, përkatësisht në shkollën "Dr. Ibrahim Rugova" kemi huazuar klasë, dhe kështu kemi arritur që të gjithë semimaturantët të vijojnë shkollimin.

Sa i përket sigurimit të ditarëve, mund të them se kemi pas vonesa paksa por më në fund janë siguruar, kështu që nuk e shoh si ndonjë problem i madh këtë, ndërsa sa i përket teksteve për nxënësit e komunitetit RAE, të jeni të bindur se të gjitha procedurat janë kryer dhe është nënshkruar kontrata me kohë, mirëpo z. Shaban Ahmeti përfaqësues i Komunitetit ka sjellë lista të shumta të nxënësve për të cilët unë kam kërkuar verifikim sepse nuk dëshiroj të siguroj dhe të shpërndaj libra për nxënës që nuk i nënshtrohen verifikimit sa i përket vijimit të procesit mësimor nga ana e tyre, pra vetëm nxënësve të komunitetit RAE që vijojnë apo vazhdojnë procesin mësimor do t’iu shpërndahen tekstet shkollorë.

z.Flakron Gashi, theksoi, replikë me drejtorin parafolës z. Avni Maloku, mirëpo njëkohësisht ju drejtohem edhe juve zotëri Kryesues i Kuvendit që pak më parë e potencove, veç po akuzoni. Unë jam jurist me profesion dhe kam për obligim t’ju tregoj se thirrja në përgjithësi ose kritika për keqmenaxhim nuk është akuzë, aktakuzat i bënë tjetër kush dhe hiqeni këtë praktikë sepse unë nuk kam akuza kundrejt askujt.

Nëse drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Avni Maloku, nuk është në dijeni se në Komunën e Podujevës kanë punuar edhe me sholla të mesme, ta pyes drejtorin paraprak z. Nexhmi Rudarin, madje kush i mban orët, kujt i ruhen orët dhe çfarë kualifikimi ka zotëriu në fshatin Batllavë, të na tregojnë drejtori njëherë e pastaj flasim në seancat e ardhshme se a janë në pyetje shkollat e mesme, shkollat e larta apo të tjera. Kërkoj ndjesë, mirëpo drejtori i Drejtorisë së Arsimit ka qenë me shkollë të mesme në kohën kur iu ka dhënë mësim nxënësve në shkollë të mesme. Çështja tjetër që gjithashtu i drejtohem drejtorit Maloku, problemet që keni ju me përfaqësuesin e komunitetit RAE z. Shaban Ahmeti është çështje tjetër, mirëpo unë po ju tregoj juve për çështjet procedurale, paaftësitë menaxhuese që keni sepse pavarësisht a janë ashkalinj apo cilit komunitet i takojnë, është dashur të bëhen më herët, dhe sot nuk kishit probleme fare, por këtë çështje e keni lënë

deri më datën 29 gusht 2016, andaj kjo tregon menaxhimin e juaj të dobët që keni zotëri drejtor, dhe do t'ju lutesha të jeni më i përgjegjshëm në fjalime.

z.Bahri Selimi, theksoi, që nuk ka angazhim të drejtorit z.Avni Maloku për sa i përket arsimit në Komunën e Podujevës jemi në dijeni të gjithë sepse në të kundërtën do të ishin gjërat më mirë në arsimin e Komunës së Podujevës. Sa i përket shkëputjes së kontratës së punëtores-edukatore, unë fillimisht nuk di se si drejtori e kupton ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe shkëputjen e kontratës, dhe çfarë dallimi bënë drejtori këtu, e them këtë sepse drejtori e tha se i është ndërprerë marrëdhënia e punës, e jo shkëputur kontrata, kurse vajza-edukatorja në fjalë është duke qëndruar në shtëpi. Çështje tjetër çka unë dëshiroj t'ju them juve drejtor, është se për atë person që ju po pretendoni se është e Lëvizjes Vetëvendosje, e keni gabim plotësisht sepse më konkretisht ajo është vajza e ish drejtorit t'juaj të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit z.Nexhmi Balaj, prandaj mos pretendoni në këtë sepse nuk ka rëndësi se cilit subjekt i takon ajo apo ai, ngase unë nuk bëjë ndarje partiake ashtu siç e bëni ju ku më parë e cekët me numra të saktë se pesë janë nga LDK, një e PDK-së dhe një e LVV-së, gjë e cila tregon qartë se ju drejtor duke mos iu interesuar fare punoni vetëm në baza partiake.

z.Haki Rudari, theksoi, unë kam propozuar që në planin e punës së Kuvendit të Komunës të jetë një informatë nga arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor dhe fillimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit të ri shkollor, dhe në parim ajo që ne sot po debatojmë është pikërisht sjellja e një informate të tillë të cilën në parim e mbështes. Nuk jam në dijeni se kush e ka bërë këtë informatë, mirëpo i nderuar drejtor, kjo është shumë e dobët, e gjymtë dhe shumë e pa konkretizuar, e cila ndoshta është dashur të përgatitet dhe të sjellët për pesë minuta, e jo nga një Drejtori e cila ka mbi 1370 mësimdhënës. Në rast se i referohemi informatës, që në fillim në një mënyrë e bënë përgjegjëse edhe Qeverinë të cilën është duke e udhëhequr LDK-ja. Drejtorja e Arsimit nga viti 2009 është në pritje të përfundimit të punimeve të objektit të ri shkollor, pra 6 vite paska pritur që të përfundoj një objekt shkollor, arsyetimet kanë qenë se Kryeministri nuk është nga radhët tona, ndërsa tani Kryeministri është i LDK-së, andaj ku është faji dhe ku është përgjegjësia.

Çështja tjetër e cila ceket në informatë, dua t'i them drejtorit, jo vetëm sa për kritikë, unë vijë nga arsimit dhe punoj që nga viti 1990, por jemi për ta ndihmuar arsimin, unë kam fëmijë në shkollë të mesme, dhe nuk e besoj që ndokush ka dëshirë ta sheh arsimin në Komunën e Podujevës në këtë gjendje si është. Më lejoni të paraqesë disa vërejtje; pranimi i mësimdhënësve pa transparencë dhe po ashtu politik, zgjedhja e drejtorëve pa transparencë dhe po ashtu drejtor të cilët janë të dëgjueshëm, mungesa e librave, mungesa e ditarëve ku javën e tretë kanë ardhur ato për të cilat Drejtorja e Arsimit, Ministria dhe Qeveria kanë qenë në dijeni se mësimi fillon me 1 ose 5 shtator, pastaj mos mbajtja e disa orëve të mësimit ku ka raste që vetëm është e shënuar lënda dhe nuk mbahet mësimi për atë lëndë edhe tani kur jemi në javën e katërt të këtij viti mësimor, siguria e nxënësve shkollë-shtëpi dhe anasjelltas, problemet për regjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme ku ka raste që mbeten nxënës me të gjitha pesëshe pa regjistruar e që mendoj se nuk është në rregull, mungesa e transparencës në përgjithësi, dhënia e subvencioneve që është diçka shumë e mirë, mirëpo kjo bëhet pa kriteret dhe me anime politike ku i jepet subvencioni një studenti që ka të punësuar 2-3 familjarë. Në vitin e kaluar ka pas rast ku një mësimdhënës ka ligjëruar katër lëndë ku asnjë prej tyre nuk e ka pasur profesion, dhe në këtë kontekst shtroj pyetje, sa arsimtar punojnë që nuk janë me profesion. Po ashtu për fund i drejtohem drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, punëtorët e partive politike nuk shikohen nga ajo prizëm që ju e cekët, por shikohen nga këndi i suksesit dhe punës së tij, kurse secili mësimdhënës e ka të drejtën e tij të përfaqësimit të një subjekti politik dhe është plotësisht normale kjo. Pra është mirë që komunikimi të jetë më i

madh në mënyrë që kjo gjendje e arsimit të jetë më e mirë e që besoj se është kërkesë dhe dëshirë e të gjithëve.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, e mbylli këtë pikë të rendit të ditës, duke kaluar në pikën e radhës.

6. Anulimi i:

- **Vendimit nr.01-066-52462 dt.29.06.2016 për inicimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, dhe**

- **Vendimit nr.01-006-52807 dt. 29.06.2016 për ngritjen e komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve të Klubit të Futbollit "Llapi" në Podujevë,**
(Për arsye se MKRS e ka vlerësuar se Vendimet janë në kundërshtim me dispozitat ligjore)

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se ne si Kuvend kemi marrë një vendim të tillë, mirëpo pas nënshtrimit të procedurave të vlerësimit të ligjshmërisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka vlerësuar se vendimi nuk ka bazë ligjore, edhe përkundër konsultimeve të Komunës me zyrtarë të asaj Ministrie ku edhe është përgatit propozimi përkatës, ne si këshilltarë të Kuvendit jemi vë në lajthitje, mirëpo atë vendim duhet ta anulojmë.

Në bazë të Ligjit të gjitha kompetencat janë referuar t'i ketë Klubi i Futbollit "Llapi", prandaj ne sot i kemi sjellë në Kuvend anulimin e vendimeve përkatëse. Ndokush mund të thotë se me kohë kemi pas vërejtje apo gjëra tjera të ngjashme, mirëpo nuk përballemi shpesh me situata të tilla ku vendimet tona mund të jetë në kundërshtim me ligjin dhe do të thoja se kjo mund të merret si diçka normale sepse edhe ne si Kuvend mund të gabojmë, andaj edhe pse ndoshta nuk ka nevojë për diskutime, e hapë debatin, fillimisht sipas Rregullores, pastaj në fund kërkoj një sqarim edhe nga zyra ligjore.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit e tha se ne si Kuvend kemi rënë në lajthitje, mirëpo të gjithë nuk kemi rënë në lajthitje sepse këtë vendim e ka marrë Grupi i LDK-së, dhe para miratimit kemi thënë se propozimi është antiligjor, ndërsa tani sjellët në Kuvend për të votuar shfuqizimin e tij, por ne kemi votuar kundër ende pa u miratuar ai vendim, ashtu votojmë edhe sot sepse e keni votuar me Grupin e LDK-së, ashtu votoni edhe anulimin e tij. Të them të drejtën ky Kuvend është bërë një lloj skene teatrale, dhe është shumë keqe që ky Kuvend është në këtë gjendje të mos zhvillimit të ecjes së misionit që ka. Unë disa herë ju kam thënë juve si Kryesues i Kuvendit që vendimet e mira i përkrahim gjithherë, mirëpo ju vetë zotëri Kryesues i vëni në lajthitje Grupin e juaj duke insistuar t'i kaloni propozim vendimet e Kryetarit të Komunës, andaj mendoj se vendimet e tua si Kryesues i Kuvendit duhet të jenë ligjore dhe të drejta, dhe duhet të merrni parasysh vërejtjet e këshilltarëve për çështje të caktuara dhe të shtyhet si pikë, të bëhen sqarime dhe konsultime me zyrën ligjore, të diskutohen çështjet me Grupet e këshilltarëve e të tjera. Megjithëse për këtë anulim nuk është diçka shumë e rëndësishme sepse është një prej punëve më të këqija të këtij Kuvendi, mirëpo si do që të jetë kalojeni edhe këtë pikë sepse ju si Kryesues nuk jeni duke e luajt rolin si duhet dhe ja keni humb rolin dhe fuqinë këtij Kuvendi si organ më lartë i Komunës, dhe njëkohësisht të preferoj të mos marrësh vendime ose propozime ashtu siç ju sjellën për interesa të Ekzekutivit të Komunës.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, në takimin e Komisionit përkatës, unë si shef i Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës kam kërkuar të ndërpritet vazhdimi i punës së komisionit, sepse në pyetjen që kam shtruar zyrës ligjore rreth ligjshmërisë së vendimit, ka pas

hamendje në këtë drejtim. Ne si Kuvend kemi marrë vendimet duke u bazuar në zyrën ligjore, këtu ka qenë problemi, dhe e gjithë dëshira jonë ka qenë të bëhet shëndrrimi i Klubit të Futbollit "Llapi" ashtu siç është kërkuar me rregulla të FIFA dhe UEFA-së, përndryshe dëshira jonë ka qenë t'i ndihmojmë Klubit në fjalë me qëllim të sjelljes së ndonjë investimi dhe ecjes përpara të Klubit.

z.Bahri Selimi, theksoi, meqë u përmend lajthitja, unë mendoj se në lajthitje ka rënë Kryetari i Komunës sepse me rastin e miratimit të rendit të ditës në atë seancë, propozim vendimi të cilin sot duhet të anulohet ka ardhur me urgjencë nga Kryetari i cili gjatë diskutimeve ka potencuar se, deshët ju apo nuk deshët ta votoni këtë çështje, unë këtë do ta bëjë, kurse edhe pas dy muajve kjo nuk u bë dhe tani del që ai vendim është në kundërshtim me ligjin. Çështje e cila më brengosë është se, ne deri në një masë jemi në dijeni për formën dhe metodën si vepron Klubi i Futbollit "Llapi", unë personalisht jam sportdashës dhe këtë Klub dëshiroj ta shohë në nivel të lartë dhe me arritje të sukseseve, mirëpo tani brengosem se pas anulimit të vendimit përkatës si do të mbetet statusi i Klubit, do të thotë se Klubi mbetet prapë OJQ, kurse ne e kemi parasysh se rregulla të reja të FIFA-së dhe UEFA-së dhe me pranimin e Kosovës në këto dy Organizata, klubet si OJQ nuk mund të përfaqësohen dhe nuk mund të marrin pjesë në gara evropiane, prandaj nëse ne dëshirojmë të kemi një Klub vetëm sa për të luajtur në këto fusha dhe vetëm sa për ta shikuar atë duke luajtur, mendoj se kjo është shumë e mangët dhe e ultë si prej Kryetarit, Kryesuesit dhe prej këshilltarëve të cilët e kanë votuar atë çështje, ngase mendoj se Klubi i Futbollit "Llapi" duhet ta ketë pretendimin, e që besoj se e ka, që të na përfaqësoj në arenën ndërkombëtare, ndërsa tani jemi në dijeni se me këtë gjendje si është nuk ka mundësi të na përfaqësoj dhe sipas disa informatave që kam nga përfaqësuesit kryesorë të Klubit vërtetë ky Klub është në një gjendje të keqe sa i përket statusit dhe në këtë aspekt mendoj se duhet sa më shpejt të merret një vendim i cili paraprakisht duhet të ketë bazë ligjore dhe pastaj të zbatohet në tërësi. Unë vërtetë ndjejë keqardhje për situatën ku ne si Kuvend i Komunës e kemi prurë Klubin e Futbollit "Llapi".

z.Flakron Gashi, theksoi, po kërkohet të anulohen vendimet e marra nga kjo asamble, kështu thuhet, por i bie nga një pjesë e asamblistëve, të datës 29 qershor 2016 ku pothuajse pas rreth tre muaj ne po kthehemi në pikën zero aty ku e kemi nisë. Gjenerali procesverbalet, janë audio incizimet, është fjala ime, është fjala e Kryetarit por edhe një pjesë e juaja që për shkak të interesit dhe rregullave të FIFA-së dhe UEFA-së po kërkohet me nguti që për tri ditë të hyjë në rend dite, faktikisht dy ditë përpara kemi marrë materialin përkatës. Ai imponim dhe ai presion politik e vë në lajthitje edhe zyrën ligjore edhe neve si asamblistë. Koha e cila ka qenë në dispozicion për ne, ka qenë e pamjaftueshme për të hulumtuar gjithë atë bazë ligjore dhe të gjejmë se a jemi duke votuar diçka mirë apo keq. Sot do të doja të ishte prezent këtu z.Agron Gërguri i cili në atë mbledhje na mbajti dërs duke thënë që votojeni ju sot e ne pas një muaji i sjellim dokumentet, e kjo është kur e nisë ditën me një gllënjë mirëpo si duket sot e paska nisë me tri ose katër gllënjka e nuk a ka gjetur derën e kësaj asambleje ku po diskutohet për vendimet që i përkasin fushës së tij. Në raste tjera mos i merrni prononcimet tona si opozitarë, vetëm politike, edhe ne jemi të arsyeshëm jemi specifik, e nuk do të thotë se i bëjmë gjërat vetëm për inate politike.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kërkoj nga këshilltarët e Kuvendit që të lejojnë zyrtarin ligjor të jap sqarime rreth kësaj çështjeje.

z.Faik Gashi, Zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, theksoi, e kam një përvojë bukur të gjatë të punës dhe t'jua them të drejtën, asnjëherë problem më të madh se me këtë vendim nuk kam pasë. Nga parafolësit u fajësuan zyrtar të ndryshëm, mirëpo fillimisht ju informoj se Kryetari i Komunës ka kërkuar nga unë bazueshmëri ligjore lidhur me këtë çështje, absolutisht po ju them se unë personalisht i kam dhënë garanci shumë të fuqishëm se këto vendime janë në baza ligjore, mirë apo keq, mund të debatojmë për këtë. Nuk dëshiroj të lëshohem krejt në historiatin e kësaj

çështjeje sepse mund të marrim kohë ndoshta 4-5 orë dhe nuk mund të vijmë deri te një përfundim. Ende pa ju sjellë propozimin e vendimit të cilin ju e keni miratuar në këtë Kuvend, unë kam kontaktuar të paktën 4-5 herë përmes e-mail, it me zyrtarë ligjor të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS), mirëpo për disa gjëra nuk kemi mund të pajtohemi, pastaj kemi pasur edhe takime me z.Feim Hoxha, drejtor i Departamentit ligjor në MKRS me të cilin jemi konsultuar dhe prap nuk kemi mund të pajtohemi për çështje të ndryshme, mirëpo unë e kam marrë për obligim ta përgatiti një propozim vendim të cilin e kam përgatit dhe të njëjtin e kam dërguar në MKRS për konsultim paraprak, por sërish nuk është marrë parasysh nga ana e tyre. Pastaj kemi vazhduar konsultimet dhe kemi përgatitur propozim vendimin tjetër të dytë duke u bazuar në konsultimet e bëra, dhe jua them haptazi se propozim vendimi përfundimtar ka dal nga konsultimet e bëra me zyrtarin ligjor të MKRS-së, dhe ja ku e kam (*jua tregon propozim vendimin përkatës me korrigjime me shkrim që vetë zyrtari i MKRS-së – Departamentit Ligjor e ka përgatitur që i njëjti të procedohet në Kuvendin e Komunës për miratim*), korrigjime të cilat i kemi bërë dhe njëkohësisht ai propozim vendim është proceduar për miratim në Kuvendin e Komunës.

Pas miratimit të atij propozim vendimi nga ana e këtij Kuvendi, dhe pas vlerësimit të MKRS-së se kinse ne nuk e kemi zbatuar ligjin, dhe pas sqarimeve shtesë që kemi kërkuar, kanë lindur ngatërresa tjera shtesë nga ana e tyre ku të njëjtit zyrtarë e implikojnë sërish komisionin të ndërmarr veprime të caktuara, dhe pajtohem plotësisht që në takimin e komisionit është kërkuar garanci ligjore nga unë për vendimin përkatës, mirëpo duke u bazuar në vlerësimin e ligjshmërisë nga ana e MKRS-së, përgjigja ime ka qenë, jo nuk ju garantoj se është i ligjshëm. Mandej kemi vazhduar me takime edhe disa herë me Departamentin ligjor të MKRS-së, nuk dëshiroj ta zgjati më shumë por kushdo që jeni të interesuar, në çdo kohë mundeni me ardhë në zyrë dhe bashkërisht mund ta diskutojmë këtë çështje ku edhe besoj se do të bindeni në atë që unë e potencova, mirëpo në takimin konsultativ të fundit që kemi qenë bashkërisht me Kryesuesin e Kuvendit, me drejtorin e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z.Abaz Llugaliu – njëherit edhe kryesues i komisionit përkatës dhe me kolegun nga zyra ligjore z.Sabedin Namani, në Departamentin ligjor të MKRS-së, përfundimisht jemi dakorduar që Kuvendi i Komunës të mos implikohet fare sa i përket rregullimit të statusit të Klubit në fjalë, por kjo çështje të mbetet vetëm çështje e Klubit të Futbollit "Llapi", sipas Udhëzimit Administrativ të MKRS-së.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se u japën sqarimet e nevojshme, andaj meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, e hedh në votim propozimet për anulimin e vendimeve përkatëse.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan;

-Vendimi për anulimin e vendimit nr.01-066-52462 dt.29.06.2016 për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, dhe

-Vendimi për anulimin e vendimit nr.01-006-52807 dt.29.06.2016 për ngritjen e komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve të Klubit të Futbollit "Llapi" në Podujevë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konstatoi se dy vendimet në fjalë u shfuqizuan ashtu siç ka rekomanduar Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në vlerësimin e ligjshmërisë së tyre. Kalojmë në pikën e radhës sipas rendit të ditës.

7. Të Ndryshme

znj.Mrika Thaqi, theksoi, kam një propozim që ne si Kuvend të organizojmë një vizitë zyrtare në Bashkinë e Sarandës në Republikën e Shqipërisë, vlen të ceket se nëse veç përkrahet ky propozim nga ana e këshilltarëve të Kuvendit, do të kemi një takim zyrtar me Kryetaren e Bashkisë së Sarandës dhe me zyrtarë tjerë të kësaj Bashkie.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i këshilltares paraprake znj.Mrika Thaqi, që të realizohet një vizitë zyrtare në Bashkinë e Sarandës në Republikën e Shqipërisë.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës mbajtur më 25 maj 2016 kam propozuar nxjerrjen e një propozim vendimi për lirim të nënave vetëushqyese nga pagesa për fëmijët e tyre në Çerdhen publike, mirëpo deri tani nuk kam marrë kurrfarë përgjigje, qoftë negative apo pozitive. Andaj kërkoj që në seancën e radhës në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe ky propozim në mënyrë që të kemi mundësi të diskutojmë rreth kësaj çështje. Njëherit pres përkrahje edhe nga Grupi i Grave Asambleiste.

Meqë nuk pati këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, *Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi këtë mbledhjen të përfunduar.*

Mbledhja përfundoi në orën 12;10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-72652
Podujevë,
26 shtator 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**